



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

dh. Prot 185
Dt. 15.09.2025

Nr. 2381 / Prot.

Tiranë, më 12/09/2025

Lënda: Dërgohet “Rregullore e studimeve të Doktoratës” dhe “Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të studimeve të Doktoratës, në Universitetin Politeknik të Tiranës”

FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS ✓

FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE

FAKULTETIT TË INXHINIERISË ELEKTRIKE

FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

FAKULTETIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE



FAKULTETIT TË GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE

INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës, bashkëlidhur po ju dërgojmë për zbatim:

- “Rregullore e studimeve të Doktoratës e Universitetit Politeknik të Tiranës”, e ndryshuar;
- “Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të studimeve të Doktoratës”, e rishikuar.


Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

REKTORI
Prof. Dr. Akli Fundo



TIRANË 2025

RREGULLORE E STUDIMEVE TË DOKTORATËS

E UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS



**UNIVERSITETI
POLITEKNIK
I TIRANES**

Sheshi "Nënë Tereza", 4

Tiranë ALBANIA

Tel: +355 4 2227914

Web: upt.edu.al

MIRATOHET

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Akli FUNDO



RREGULLORE E STUDIMEVE TË

DOKTORATËS

E UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Tiranë 2025

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e aplikimit

1. Rregullorja e studimeve të doktoratës në UPT administron studimet e doktoratës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studimet e doktoratës kanë për qëllim kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese në të gjitha fushat inxhinierike, të arkitekturës dhe urbanistikës, të ofruara pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.
2. Në përfundim të studimeve të doktoratës, lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor” në fushën përkatëse të studimit.
3. Rregullorja e studimeve të doktoratës vendos rregullat normative të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e saj, të drejtat e detyrimit e studentëve, rregullat për kualifikim, si dhe raportet me organet drejtuese përgjegjëse për studimet e doktoratës. Kjo rregullore zbatohet në njësitë bazë/kryesore dhe komisionet e përhershme për dhënie të gradës shkencore “Doktor”, të quajtur në UPT si Këshillat Profesorëve (KP) të njërive kryesore të UPT-së.

Neni 2

Baza ligjore

Rregullorja mbi organizimin e studimeve të doktoratës në UPT bazohet në:

1. Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
2. Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’”, i ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar;
4. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar;
5. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 75, datë 12.2.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”;
6. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”;
7. Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimit të programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar;
8. Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 16, datë 08.07.2019, “Për pajisjen e institucioneve të Arsimit të Lartë me Regjistrin Themeltar të studentëve, Regjistrin e Arrijve Akademike dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave dhe Certifikatave”;
9. Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 29, datë 18.12.2019, “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërore të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”;
10. Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të

Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar;

11. Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 10, datë 30.3.2020, “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e Arsimit të Lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, i ndryshuar;
12. Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, i ndryshuar;
13. Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës;
14. Kodin e Etikës së Universitetit Politeknik të Tiranës.

Neni 3

Organizimi i Studimeve të Doktoratës

1. Studimet e doktoratës, zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste, kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
2. Njësia bazë/kryesore, përgjegjëse për programin e studimeve të doktoratës duhet të garantojë standardet akademike dhe të ofrojë infrastrukturën e domosdoshme për realizimin e projektit kërkimor shkencor.
3. Studimet e doktoratës, organizohen brenda një projekti kërkimor-shkencor e zhvillimor dhe realizohen në koordinim me veprimtari të kërkimit të grupeve kërkimore brenda njësisë bazë, njërive kryesore dhe UPT-së. Këto projekte kërkimore shkencore dhe zhvillimi, duhet të jenë të aprovuara dhe me financim të siguar nga njësia bazë/kryesore propozuese në UPT, apo burime të tjera të ligjshme. Pas aktit të hapjes/riorganizimit të programit të studimeve të doktoratës dhe certifikimit të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, këto njësi aplikojnë për financim pranë AKKSHI-t apo pranë institucioneve të tjera financuese kombëtare dhe ndërkombëtare. Në rastet e kandidatit me statusin e personelit akademik të brendshëm, studimet e doktoratës mund të mbështeten në burimet e brendshme të UPT-së. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, kandidati mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo dhe të vetëfinancohet.
4. Studimet e doktoratës organizohen në fusha/nënfusha kërkimi. Ato përmbajnë veprimtari kërkimore shkencore, me qëllim garantimin e formimit në fushën/nënfushën përkatëse të studimit.
5. Studimet e doktoratës zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe jo më shumë se 5 vite akademike. Në raste të veçanta, për arsye objektive të justifikueshme, me propozim nga njësia bazë dhe miratim nga Këshilli i Profesorëve të njësive kryesore, studimet e doktoratës mund të shtyhen deri në 1 vit.
6. Njësia bazë/kryesore, në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë, përcakton kriteret specifike, kur studimet e doktoratës ndërpriten, shtyhen ose pezullohen.
7. Në rast se disertacioni nuk paraqitet për fillim të procedurës së mbrojtjes edhe brenda afatit të tejkëqitur (pa justifikim bindës), KP, me propozim të njësive bazë, ndërpret vazhdimin e doktoratës.



8. Kur studimet e doktoratës, zhvillohen në bashkëpunim midis UPT-së dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.
9. Studimet e doktoratës, mund të përmbajnë veprimtari të formimit të thelluar teorik, bazuar në rekomandimet përkatëse të drejtuesit shkencor të doktoratës, për të përvetësuar metodologjitë bashkëkohore të kërkimit, aplikimit, etj.
10. Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti është në varësi të projekteve kërkimore brenda njësive bazë.
11. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë. Ky numër përfshin udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është i angazhuar.
12. Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës, zhvillohen në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, SHBA-ve dhe Kanada, bashkudhëheqësi shkencor në këto vende pritëse, mund të jetë edhe me gradën shkencore “Doktor”.
13. Kriteret për përzgjedhjen e udhëheqësit, përcaktohen në rregulloren e programit të studimit dhe në akte të tjera të njësisë bazë/kryesore përgjegjëse. Në këto akte përcaktohen edhe modalitetet e ndryshimit apo zëvendësimit të udhëheqësit, në rastet kur është e nevojshme dhe e argumentuar.
14. Numri i doktorantëve që udhëheq çdo anëtar i personelit akademik, brenda të njëjtës periudhë, përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë brenda vendit dhe udhëheqjet/bashkudhëheqjet që ndjek në institucionet e arsimit të lartë brenda vendit ose vendet anëtare të OECD-së, BE-së ose G-20-ës ku ai është i angazhuar është:
 - a) jo më shumë se 3 (tre), në rastin e personelit akademik që mban titullin “Profesor”;
 - b) jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin “Profesor i Asociuar”;
15. UPT me njësitë kryesore përbërëse, kryen kontrollin digjital antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore “Doktor”, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Propozimi për hapjen e studimeve të doktoratës

1. Nisma për hapjen/riorganizimin e studimeve të doktoratës bëhet nga njësia bazë/kryesore dhe numri i studentëve doktorantë përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore. Propozimi për hapjen/riorganizimin e studimeve të doktoratës dhe numri i studentëve doktorantë i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore.
2. Njësitë bazë/kryesore, që ofrojnë studime të doktoratës, i riorganizojnë studimet në përputhje me fushat e tyre të ekspertizës, burimeve njerëzore, kapacitetet e akademike pritëse dhe përcaktimeve ligjore në fuqi dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë si dhe i miratojnë në instancat institucionale, në përputhje me Statutin e UPT-së dhe rregulloret e tij. Kur fushat e kërkimit janë të ndërthurura ndërmjet dy ose më shumë njësive bazë, njëra prej njësive bazë caktohet përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakortësi ndërmjet tyre.



3. Drejtuesi i njësisë kryesore i përcjell për shqyrtim propozimin Këshillit të Profesorëve të asaj njësie.
4. KP-ja brenda një muaji nga data e propozimit për hapjen/riorganizimin e studimeve të doktoratës, shqyrton nëse propozimi përputhet me kërkesat ligjore të parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Drejtuesi i njësisë kryesore e përcjell atë në Rektorat, i cili ka detyrimin e përcjelljes së propozimit në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit.
5. Pas miratimit nga Senati të propozimeve për hapjen/riorganizimin e studimeve të doktoratës, Rektori i UPT-së i përcjell ministrisë përgjegjëse për arsimin, informacionin mbi numrin e kuotave, llojin e tyre dhe projektet e parashikuara kërkimore.
6. Pas shpalljes së rezultateve të verifikimit nga ministria përgjegjëse për arsimin, e cila certifikon përmbushjen e kriterëve të IAL-së në lidhje me kapacitetet pritëse, UPT shpall kuotat e doktoratave.
7. Programet e përbashkëta të studimeve të doktoratës organizohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe Statutin e UPT-së.

Neni 5

Njoftimi për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës

1. Hapja e pranimeve për studimet e doktoratës bëhet me urdhër të Rektorit dhe shpallet në mediat elektronike/të shtypit të shkruar, në mjediset e njësisë kryesore si dhe në faqen zyrtare të UPT-së.
2. Njoftimi duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
 - a. Fushat e studimeve të doktoratës;
 - b. Kuotat e doktoratës për çdo fushë studimi;
 - c. Dokumentacionin e nevojshëm për aplikim;
 - d. Afatin për paraqitjen e aplikimit;
 - e. **Kriteret e pranimit.**

Neni 6

Pranimi i kandidatëve në studimet e doktoratës

Në studimet e doktoratës pranohen kandidatët që kanë:

- a. Diplomë universitare "Master i Shkencave" (ose DND) në UPT;
- b. Diplomë e sistemit të vjetër 5-vjeçar në UPT;
- c. Master i Shkencave ose DND të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në programin e studimeve të doktoratës ose në rregulloren e saj.
- d. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- e. Mesatare të ponderuar të notave në ciklin e parë të studimeve (diploma Bachelor/DNP) dhe në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave/DND, të



- programeve të integruara të nivelit të dytë dhe të sistemit të vjetër 5-vjeçar, jo më të vogël se 8 (tetë), ose jo më pak se 80 % e pikëve totale.
- f. Njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin e miratuar nga SAUPT, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
 - g. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.
 - h. Njësia bazë/kryesore, në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë, sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit të parë dhe të dytë, përcakton kriteret specifike që kandidati duhet të plotësojë për t'u pranuar, sipas fushës së kërkimit.

Neni 7

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Kandidatët aplikojnë për t'u regjistruar në studimet e doktoratës me dosje individuale, e cila dorëzohet në sekretarinë e njësisë kryesore dhe duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- a. Kërkesën e kandidatit drejtuar njësisë bazë, që është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të doktoratës, ku të përfshihet fusha e studimit të doktoratës, që kërkon të ndjekë dhe drejtuesi shkencor;
- b. Deklaratë e drejtuesit shkencor për udhëheqjen e studimit të doktoratës, në fushën e përzgjedhur;
- c. Propozim për temën e kërkimit/metodologjinë/pritshmëritë, firmosur nga udhëheqësi;
- d. Letër motivimi;
- e. CV personale;
- f. Lista e punimeve shkencore të dokumentuara, nëse ka të tilla;
- g. Kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- h. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë "Master Ekzekutiv", diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
- i. Fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
- j. Dy fotografi;
- k. Dy rekomandime nga persona me titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar", ku njëri prej të cilëve duhet të mbulojë fushën përkatëse të kërkimit shkencor;
- l. Vetëdeklarim ku kandidati pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të studimeve të doktoratës, sipas përcaktimeve të bëra nga UPT;



- m. Dëshmi të gjuhës së huaj, sipas kornizës ligjore në fuqi;
- n. Dokument të plotësimit të kritereve specifike që ka përcaktuar njësia kryesore;
- o. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar;
- p. Mandat pagese për tarifën e aplikimit.

Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e aplikantëve në fazën e aplikimit.

Neni 8

Përzgjedhja e kandidatëve për studimet e doktoratës

1. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga njësia bazë përgjegjëse për studimet e doktoratës.
2. Pranë njësisë bazë ngrihet komisioni “ad-hoc” me tre deri në pesë anëtarë, kryetar i të cilit është drejtuesi i projektit kërkimor fitues. Komisioni “ad-hoc” propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore për miratim. Anëtarët e komisioni “ad-hoc” janë anëtarë të njësisë bazë, që i përkasin kategorisë “Profesor” ose në mungesë, të kategorisë “Lektor”, të cilët janë specialistë të fushës përkatëse të kërkimit ose fushave të përafërta.
3. Komisioni “ad-hoc” duhet të mblidhet për të bërë vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve, mbështetur në dosjet e aplikimit, jo më vonë se dy javë pas mbylljes së aplikimeve. Komisioni “ad-hoc” shpall renditjen paraprake të kandidatëve brenda 5 ditëve pune.
4. Lista me renditjen e kandidatëve dhe dosjet e tyre, i përcillen drejtuesit të njësisë kryesore, i cili i’a përcjell për miratim KP-së. KP shpall listën paraprake të kandidatëve fitues me drejtuesit shkencorë përkatës, brenda 5 ditëve pune.
5. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke plotësuar fillimisht nevojat për kualifikimin e personelit akademik të punësuar me kohë të plotë në UPT.
6. Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve, brenda tri ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues. Ankimimi bëhet pranë sekretarisë së njësisë kryesore.
7. KP-ja trajton ankimimet dhe i kthen përgjigje zyrtare në përputhje me procedurat administrative, brenda pesë ditëve pune. KP-ja shpall listën përfundimtare të kandidatëve fitues.
8. Renditja përfundimtare e kandidatëve fitues publikohet në faqen zyrtare të njësisë kryesore përgjegjëse, si dhe në ambientet e saj.
9. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë e njësisë kryesore përgjegjëse për studimet e doktoratës, brenda dy javëve nga data e shpalljes së listës së kandidatëve fitues.
10. Në rast se një kandidat tërhiqet ose nuk regjistrohet brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai e humbet të drejtën e vazhdimit të studimeve të doktoratës dhe në vend të tij regjistrohet kandidati vijues në listën përfundimtare brenda një afati 5 ditë pune.
11. Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e procesit të përzgjedhjes dhe vendimmarrjes të kandidatëve aplikantë dhe fitues.
12. Dokumentacioni i aplikimit të kandidatëve fitues depozitohet në sekretarinë e njësisë kryesore dhe pasurohet gradualisht me të gjithë dokumentacionin që provon ecurinë e doktorantit gjatë realizimit të studimeve të doktoratës.



13. Kandidatët fitues paguajnë tarifën për regjistrim në programin e studimit të doktoratës ku janë shpallur fitues.

Neni 9

Realizimi i studimeve të doktoratës

Njësia bazë/kryesore, në rregulloren e programit të studimit të doktoratës, bashkërendon në funksion të realizimit të projektit kërkimor shkencor, veprimtarinë kërkimore shkencore dhe krijuese të studentëve si dhe parashikon në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit dhe funksionimit të programit të doktoratës.

1. Studimet e doktoratës organizohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese, të cilat zhvillohen në bashkëpunim të studentit me udhëheqësin shkencor.
2. Studenti, në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor, prezanton planin e zhvillimit dhe metodologjinë e kërkimit, të cilat diskutohen dhe miratohen në njësinë bazë, ku studenti ndjek studimet e doktoratës. Plani i zhvillimit duhet të detajojë etapat e realizimit të kërkimit shkencor dhe realizimit të botimeve dhe referimeve shkencore.
3. Plani i punës përmban:
 - a) Formimin e thelluar teorik që duhet të kryejë studentit;
 - b) Kontributin në mësimdhënie pranë njësisë bazë;
 - c) Metodologjinë e kërkimit;
 - d) Fazat e zhvillimit të kërkimit;
 - e) Kontrollin e ecurisë së punës;
 - f) Grafikonin e zhvillimit të punës për çdo muaj ku specifikohet qartë se ku zhvillohet fizikisht secili proces i parashikuar.

Eventualisht, elementët e planit të punës mund të pasqyrohen në rregullore në nivel njësie bazë/kryesore, së bashku me parashikimin në mënyrë të detajuar të administrimit të të dhënave të çdo doktoranti, lidhur me veprimtarinë kërkimore shkencore e krijuese të tij dhe detyrimin për raportimin e vlerësimit të progresit të doktorantit.

4. Njësia bazë/kryesore përgjegjëse, në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve, përcakton kriteret specifike për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor gjatë periudhës së studimeve të doktoratës.
5. Raportet e progresit përgatiten nga studentët e doktoratës, në bashkëpunim me udhëheqësin, konfirmohen nga drejtuesi i projektit kërkimor-shkencor dhe studentët mund të zhvillojnë aktivitetin e tyre, dhe më pas shqyrtohen e miratohen çdo vit akademik në njësinë bazë përgjegjëse dhe dërgohen/depozitohen pranë KP-së.
6. Puna kërkimore-shkencore duhet të paraqitet në formatin e një disertacioni, sipas modelit që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje. Disertacioni është pjesë e punës kërkimore-shkencore, me nivel të lartë akademik në lidhje me formulimin e argumenteve të kërkimit, bazën konceptuale, aspektet teorike, metodologjinë, dokumentimin dhe saktësinë e tij, përdorimin e literaturës dhe prezantimin e punës gjatë mbrojtjes para Jurisë.
7. Studenti doktorant, në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor, përpara mbrojtjes së

disertacionit, mund të kërkojë saktësimin e temës së punimit që më mirë paraqet aktivitetin kërkimor shkencor dhe zhvillimor të arritur gjatë këtij cikli studimi. Saktësimi i temës së punimit, si rregull, miratohet në prezantimin e fundit që kandidati realizon në njësinë bazë, përpara se të përgatitet për mbrojtjen e doktoratës dhe dërgohet/depozitohet pranë KP-së. Saktësimi i temës, nuk ndryshon projektin individual të studentit dhe as fushën/nënfushën kërkimore.

8. Disertacioni duhet të përfshijë kontribute origjinale në zhvillimin e njohurive të reja teorike/aplikative kundrejt disiplinës përkatëse dhe të ketë një standard akademik, i cili të justifikojë publikimin si pjesë e literaturës në fushën përkatëse.
9. UPT me njësitë kryesore, kryen kontrollin digjital antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore “Doktor”, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
10. Kandidatët duhet të hartojnë disertacionin në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje të tij (2000– 4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, në format të shtypur dhe elektronik, në përputhje me formatin bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Për programet e përbashkëta të ciklit të tretë “Doktoratë”, disertacioni mund të jetë edhe në një nga 5 gjuhët e BE.

Neni 10

Kriteret bazë për fitimin e gradës shkencore “Doktor”

1. Kriteret bazë që duhet të plotësojë studentit përpara mbrojtjes së disertacionit janë:
 - a) Të ketë realizuar si autor i parë ose dhe i dytë, kur autor i parë është udhëheqësi, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat, të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-s, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;
 - b) Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara ku është autor i parë ose autor i dytë. Së paku, 1 (një) prej artikujve të jetë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI), ku është së paku autor i dytë;
 - c) Të ketë realizuar të paktën 2 (dy) referime në njësinë bazë. Referimi i parë duhet të bëhet brenda dy viteve të para të studimit. Referimi i fundit, përmbledhjen e kërkimit shkencor dhe përveç të dhënave të reja, duhet të bëjë edhe përmbledhjen e rezultateve të gjithë punës kërkimore;
 - d) Të gjitha referimet dhe botimet duhet të pasqyrojnë aspekte të punës kërkimore, që i përkasin realizimit të planit të zhvillimit të projektit kërkimor;
 - e) Të ketë përgatitur dhe dorëzuar në departament disertacionin së bashku me një përmbledhje, të miratuara paraprakisht dhe të firmosura nga udhëheqësi shkencor.

Neni 11

Programet e përbashkëta të doktoratës

1. Universiteti Politeknik i Tiranës mund të organizojë programe të përbashkëta të studimit të doktoratës me një ose më shumë universitete të tjera (vendase ose të huaja), në bazë marrëveshjesh, duke pasur parasysh si më poshtë:
 - a. Programi i studimit të doktoratës, aktiviteti i kërkimit shkencor si dhe përgatitja e tezës së saj të kryhen me periudha të alternuara në secilin prej universiteteve pjesëmarrëse sipas marrëveshjes mes palëve;
 - b. Caktimin e dy udhëheqësve, një për secilin institucion në përputhje me Nenin 12 në vijim;
 - c. Vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për avancimin e studentit në studimet e doktoratës, deri në përmbylljen e tyre;
 - d. Caktimin e gjuhës në të cilën do të hartohet dhe paraqitet punimi i doktoratës apo pjesë të tij, përcaktuar në marrëveshjen midis institucioneve;
 - e. Anëtarët e Jurisë për mbrojtjen e tezës caktohen me vendim të drejtuesve të secilës njësi bazë/kryesore të angazhuar në këtë punim;
2. Rregullimi i detajuar i këtyre programeve bëhet me rregullore të përbashkëta të posaçme, mbështetur në rregulloret përkatëse të institucioneve partnere.

Neni 12

Udhëheqësi shkencor

1. Drejtuesit shkencorë të studentëve të doktoratës i përkasin kategorisë “Profesor” dhe janë personel akademik efektiv në UPT, në përputhje me Nenin 65 të Ligjit 80/2015, për *“Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*.
2. Drejtuesi shkencor i studentit është pjesë e grupit të punës të projektit kërkimor-zhvillimor ku ngrihet projekti individual kërkimor-zhvillimor i studentit.
3. Personeli akademik dhe udhëheqësit e programit të doktoratës përzgjidhen nga njësia përgjegjëse pas konsultimit me Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”. Miratimi i udhëheqësit shkencor bazohet në përputhshmërinë e fushës së studimeve të tij, arritjeve dhe projektit të doktorantit.
4. Drejtuesi shkencor i doktorantëve ka të drejtë:
 - a. Të udhëheqë dhe vlerësojë aktivitetin e studentit doktorant në përputhje me autonominë profesionale dhe akademike, duke ndjekur kërkesat e programit të studimit të Doktoratës dhe duke respektuar interesat profesionale të doktorantit;
 - b. Të drejtën për një vlerësim objektiv dhe të pa anshëm të punës së tij në përputhje me metodologjinë specifike të procesit të vlerësimit.
 - c. Të njohë metodologjinë e vlerësimit të punës së tij si dhe rezultatet e këtij vlerësimi.
 - d. Të refuzojë udhëheqjen e një kandidati doktorant në rast se vihet kundër dëshirës së tij në një konflikt interesi ose për arsye të tjera objektive.
 - e. Të propozojë përjashtimin e një studenti doktorant nëse sheh se nuk janë respektuar



ose janë shkelur rregullat shkencore dhe etike.

5. Udhëheqësi shkencor i doktoratës ka detyrime dhe përgjegjësi:
 - a. Të drejtojë, këshillojë, vlerësojë nevojat e studentit, si edhe të mbështesë zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës kërkimore të tij.
 - b. Të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave shkencore dhe etike gjatë periudhës së udhëheqjes së doktoratës.
 - c. Të sigurojë që doktoranti njih dhe respekton rregullat e pronësisë intelektuale dhe plagjiaturës në punimin shkencor si dhe pasojat që rezultojnë nga mos respektimi i tyre.
 - d. Të angazhohet që udhëheqja e studentit për realizimin e kërkimit shkencor dhe disertacionit të kryhet brenda afateve të përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi.
 - e. Të garantojë realizimin e projektit kërkimor shkencor të studentit doktorant duke ofruar eksperiencën e vet, udhëzimet e duhura dhe mbështetjen akademike të vazhdueshme të tij në përmbushje të qëllimit dhe objektivave. Kjo përfshin ndër të tjera edhe mbështetjen dhe konsulencën në:
 - Strukturën e punimit;
 - Metodologjinë e Kërkimit Shkencor;
 - Literaturë dhe burime të tjera të informacionit;
 - Përgatitja dhe përmbajtja e punimit shkencor;
 - Realizimi i botimeve dhe referimeve shkencore, etj.
 - f. Të sigurojë kushtet dhe të stimulojë progresin e kandidatit doktorant në punën kërkimore.
 - g. Të mbajë takime të rregullta, zyrtare dhe të dokumentuara me studentin doktorant të cilat do të shërbejnë për vlerësimin e raporteve të progresit të doktorantit.
 - h. Të miratojë planin e veprimtarive në vijim në bazë të ecures së punës së studentit doktorant.
 - i. Të miratojë raportet vjetore të progresit që dokumenton ecurinë e punës kërkimore-shkencore të doktorantit.
 - j. Të mbështesë përfshirjen në mësimdhënie, pjesëmarrjen në konferenca, etj. të kandidatit doktorant.
 - k. Të dorëzojë zyrtarisht dhe në mënyrë korrekte kopjen elektronike të disertacionit të kandidatit si dhe të kërkesës për vlerësim të origjinalitetit dhe përputhshmërisë, tek personi përgjegjës për sistemin antiplagjiaturë në rang Institucioni në përputhje me procedurën operationale DKSHP 01.02.00 (*Procedura operationale për aplikimin anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës*).
 - l. Të garantojë plotësimin e të gjitha vërejtjeve dhe rekomandimeve të Jurisë, kur disertacioni rikthehet për plotësim.

Neni 13

Bashkudhëheqje e studimeve të doktoratës

1. Studentët e doktoratës, për zhvillimin e projektit të tyre individual të kërkimit shkencor,



- mund të bashkudhëhiqen deri në dy udhëheqës shkencorë njëkohësisht. Bashkudhëheqja, në të gjitha rastet është me personel akademik të kategorisë “Profesor” të cilët janë anëtarë të grupit të punës të projektit kërkimor-zhvillimor ku zhvillohet studimi i doktoratës.
2. Për programet e përbashkëta ose ndërdisiplinore të Doktoratës, caktohen dy udhëheqës për drejtimin e kandidatëve, një nga secila njësi bazë bashkëpunuese.
 3. Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës kryhet në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, SHBA-ve dhe Kanada-së, bashkudhëheqësi në institucionin pritës mund të jetë me gradën shkencore “Doktor”.
 4. Në rast të angazhimit të personel akademik si bashkudhëheqës nga IAL tjetër përtej UPT-së, është e mundur nëse:
 - a. Ekziston një marrëveshje mes dy institucioneve ku të jetë e parshikuar bashkudhëheqja e studimeve të ciklit të tretë;
 - b. Letër angazhimi e udhëheqësit jashtë UPT-së për udhëheqjen e ciklit të tretë të studimeve në UPT, e miratuar nga drejtuesi i njësisë bazë të përkatësisë në institucionin jo-UPT;
 - c. Argumentim nga njësia bazë në UPT se, ekspertiza e bashkudhëheqësit, i cili nuk është personel akademik efektiv i UPT-së, është plotësuese dhe e nevojshme për përfundimin me sukses të projektit kërkimor-shkencor individual të studentit;
 - d. Personeli akademik jo i UPT-së, duhet të jetë pjesë e grupit të punës të projektit kërkimor-zhvillimor ku ngrihen studimet e doktoratës;
 - e. Identifikimi i qartë në planin e punës së studimit doktoral të ekspertizës, fushës së kompetencës dhe rolit të secilit udhëheqës për përfundimin me sukses të studimeve të doktoratës;
 - f. Personeli akademik efektiv i UPT-së, është udhëheqësi i parë i studentit dhe luan rolin koordinues me njësinë bazë, ndërsa personeli akademik bashkudhëheqës nga jashtë UPT-së, është udhëheqësi i dytë.
 5. Në rast të bashkudhëheqës me personel akademik efektiv të UPT-së, kërkohet:
 - a. Argumentimi nga njësia bazë se bashkudhëheqja është e nevojshme për plotësimin e kompetencave në udhëheqjen e studimeve të doktoratës;
 - b. Në rast bashkudhëheqje me personel akademik efektiv nga njësi bazë, të ndryshme nga ajo e zhvillimit të studimit të doktoratës, kërkohet marrëveshje mes njësive bazë ku të jetë e përcaktuar udhëheqja/bashkudhëheqja e studimeve të doktoratës;
 - c. Identifikimin e udhëheqësit kryesor koordinues me njësinë bazë.

Neni 14

Ndryshimi i udhëheqësit shkencor

1. Njësia bazë/kryesore përgjegjëse për programin e doktoratës, në bashkëpunim me studentin, garanton vijimësi në udhëheqjen e tij brenda projektit kërkimor-zhvillimor në të cilin është pranuar për zhvillimin e studimeve të ciklit të tretë Doktoratë.
2. Udhëheqësi shkencor mund të heqë dorë nga udhëheqja e një kandidati për arsye madhore siç janë ato shëndetësore, pamundësi të diktuar nga kushte familjare apo të tjera të arsyeshme, e që gjykohen se e bëjnë të pamundur ndjekjen dhe plotësimin e detyrimeve ndaj detyrës.



3. Udhëheqësi paraqet kërkesën me shkrim për dorëheqje duke argumentuar arsyet dhe dokumentuar, aty ku është e mundur, vërtetësinë e arsyeve të dorëheqjes.
4. Kërkesa për dorëheqje i paraqitet drejtuesit të njësisë kryesore që mbulon programin e studimit, i cili, ja përcjell këtë njësisë bazë për të propozuar një udhëheqës tjetër në përputhje me kriteret në fuqi dhe përputhshmërinë me fushën e nënfushën e kërkimit dhe projektin kërkimor-zhvillimor të miratuar.
5. Kandidati ka gjithashtu të drejtë të kërkojë ndryshimin e udhëheqësit të tij shkencor, kur ky/kjo e fundit nuk përmbush detyrimet e parashikuara në këtë rregullore.
6. Kërkesa për ndryshimin e udhëheqësit shkencor duhet të mbështetet në prova dokumentare të cilat provojnë qartë mos respektimin e pikave më lart nga ana e udhëheqësit shkencor.
7. Zëvendësimi i udhëheqësit shkencor, përveç rasteve të pa parashikuara, objektive dhe të dokumentuara, mund të iniciohet jo më vonë se një vit akademik përpara përfundimit të kohëzgjatjes normale të studimeve.
8. Zëvendësimi i udhëheqësit shkencor në të gjitha rastet, bëhet me anëtar tjetër të grupit të punës në të njëjtin projekt kërkimor-zhvillimor si dhe miratohet me vendim të njësisë bazë përkatëse.
9. Për rastet e zëvendësimit të udhëheqësit shkencor, kur brenda grupit të punës të projektit nuk ka më kapacitete akademike të lira, me propozim të drejtuesit të projektit apo anëtarëve të tjerë të projektit dhe argumentimin përkatës, njësi bazë mund të miratojë me vendim, shtimin e anëtarëve të tjerë të kategorisë profesor, që kanë kapacitete të lira akademike, brenda fushës së kompetencës së projektit kërkimor-zhvillimor, vetëm për këtë rast.
10. Zëvendësimi i udhëheqësit shkencor përcillet për miratim pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe institucioneve përkatëse të vartësisë, së bashku me dokumentacionin bazë si vijon:
 - a. Vendimi i njësisë bazë mbi miratimin e zëvendësimit të udhëheqësit shkencor;
 - b. Vendimi i KP-së të njësisë kryesore mbi miratimin e zëvendësimit të udhëheqësit shkencor;
 - c. Deklarata e dakortësisë së udhëheqësit për heqje dorë nga udhëheqja aktuale (nëse është e aplikueshme) apo argumentimet objektive të nevojës së ndërrimit të udhëheqësit;
 - d. Deklarata e dakortësisë dhe angazhimit të udhëheqësit shkencor të ri për praninë të kandidatit;
 - e. Deklarata e dakortësisë së kandidatit për ndërrimin e udhëheqësit shkencor.

Neni 15

Të drejtat dhe detyrat e studentit të doktoratës



Studenti i doktoratës ka të drejtë:

1. Të informohet për aktet rregullatore në fuqi të cilat janë në funksion të procesit të studimeve të doktoratës dhe mbrojtjes së disertacionit për fitimin e gradës shkencore "Doktor";
2. Të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e veprimtarive akademike dhe shkencore të

parashikuara në programin e tij të studimeve të doktoratës;

3. Të ketë qasje në të gjitha bibliotekat e institucionit, në varësi të karakteristikave përkatëse të kërkimit shkencor;
4. Të ketë qasje dhe përdorimi të ambienteve studimore/kërkimore të njësisë bazë ku zhvillon studimet e doktoratës, dhe sipas nevojës, me marrëveshje mes drejtuesve të njësive bazë në UPT, edhe të ambienteve dhe infrastrukturës kërkimore të njësive të tjera bazë;
5. Të tërhiqet vullnetarisht nga studimet e doktoratës, duke paraqitur kërkesë me shkrim pranë drejtuesit të njësive kryesore;

Studenti i doktoratë ka detyrime:

1. Të njohë dhe të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga aktet rregullatore në fuqi;
2. Të respektojë programin e miratuar të doktoratës;
3. Të respektojë afatet e parashikuara për zhvillimin e studimeve të doktoratës;
4. Të raportojë në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor në njësinë bazë, të paktën një herë në vit, mbi ecurinë e punës për realizimin e programit të kërkimit shkencor dhe veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore;
5. Të zbatojë standardet shkencore, etike dhe rregullatore, të parashikuara për studimet e doktoratës;
6. Të respektojë etikën dhe integritetin në kërkimin shkencor.

Neni 16

Dorëzimi i tezës dhe ngritja e jurisë

1. Dosja e studentit të doktoratës, së bashku me kopjet e përfunduara të disertacionit, të firmosura nga kandidati dhe udhëheqësi/udhëheqësit shkencorë, dorëzohen pranë drejtuesit të njësive kryesore, së bashku me një kërkesë për fillimin e procedurës për fitimin e gradës shkencore “Doktor”.
2. Njësia bazë/kryesore përgjegjëse, në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë, përcakton kriteret specifike që kandidati duhet të plotësojë përpara mbrojtjes përfundimtare të tezës së disertacionit.
3. Drejtuesi i njësive kryesore brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data e dorëzimit të dosjes, ia përcjell dosjen për vlerësim njësive bazë. Njësia bazë brenda 30 (tridhjetë) ditëve jep vlerësimin dhe ia përcjell atë KP-së së njësive kryesore.
4. Në rast se njësia bazë jep vlerësim negativ për disertacionin/dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë dosjen e plotësuar me disertacionin pas një periudhe jo më të shkurtër se (tre) muaj.
5. Anëtarët e Jurisë për mbrojtjen e grades shkencore “Doktor” i përkasin kategorisë “Profesor” dhe propozohen nga njësia bazë, me miratimin e drejtuesit të njësive kryesore. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë), nga të cilët së paku 5 janë personel akademik efektiv i UPT-së dhe 3 janë jashtë saj.
6. KP, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre Jurinë me 5 anëtarë për vlerësimin e disertacionit, 2 (dy) nga të cilët, u përkasin njësive bazë nga institucione homologe vendase ose të huaja. Dy anëtarë të Jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e



- disertacionit, njëri prej të cilëve i përket njërive bazë nga institucione homologe vendase ose të huaja.
7. Drejtuesi i njësisë kryesore i përcjell Rektorit të UPT-së Jurinë e ngritur nga KP.
 8. KP, nëse e vlerëson negativisht dosjen (për mos respektim të procedurave), e rikthen për plotësim pranë njësisë bazë.
 9. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj.
 10. Kandidati duhet të pajisë çdo anëtar të Jurisë me një kopje të disertacionit dhe mendimin e përgatitur nga udhëheqësi shkencor.
 11. Njoftimi për datën dhe vendin e mbrojtjes së disertacionit bëhet publik nga njësia kryesore.

Neni 17

Mbrojtja e disertacionit të doktoratës

1. Disertacioni i doktoratës paraqitet para Jurisë, e cila e vlerëson atë.
2. Mbrojtja e doktoratës si rregull bëhet e hapur, me përjashtim të rasteve kur, për natyrën e veçantë të çështjeve të trajtuara (sekrete, të dhëna konfidenciale etj.) duhet të bëhet e mbyllur sipas vendimit përkatës të KP-së.
3. Paraqitja e disertacionit bëhet me pjesëmarrjen e plotë të Jurisë. Kur mungon ndonjë pjesëtar i Jurisë, mbrojtja shtyhet për një datë tjetër dhe njoftohet KP-ja për datën e re.
4. Në rast se edhe në datën e dytë, ka mangësi të pjesëtarëve të Jurisë, KP-ja merr vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Jurisë.
5. Nëse doktoranti nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar drejtuesit të njësisë kryesore kërkon shtyrjen e mbrojtjes për shkaqe të arsyeshme, atëherë mbrojtja konsiderohet e pezulluar. Drejtuesi i njësisë kryesore informon me shkrim Komisionin e Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, Jurinë dhe udhëheqësin shkencor mbi pezullimin e procedurës. KP-ja pasi shqyrton rastet, shprehet me vendim. Juria, në dakordësi edhe me studentin doktorant, cakton një datë të dytë për mbrojtjen e disertacionit, brenda një periudhe tre mujore nga data e ngritjes së saj.
6. Procedura e paraqitjes së doktoratës përfshin:
 - a) Leximin nga Kryetari i Jurisë të vendimit të KP-së për lejimin e mbrojtjes së disertacionit;
 - b) Paraqitje e përmbledhjes së disertacionit nga kandidati për një kohë prej 30-45 minuta;
 - c) Paraqitja e mendimit të udhëheqësit shkencor;
 - d) Paraqitje e dy oponencave;
 - e) Sqarimi i kandidatit dhe udhëheqësit shkencor për vlerësimin e dhënë nga oponentet;
 - f) Pyetje dhe diskutime nga anëtarët e Jurisë rreth disertacionit, si dhe përgjigjet për to në trajtën e një debati të drejtpërdrejtë.
7. Vlerësimi bëhet me pikë nga secili anëtar i Jurisë. Çdo anëtar vlerëson disertacionin deri në 10 pikë. Në procesverbalin që nënshkruhet nga anëtarët e Jurisë paraqitet përmbledhje e pikëve dhe vlerësimi përkatës, si në vijim:
 - 45 - 50 pikë = shumë mirë;
 - 36 - 44 pikë = mirë;



- 30 - 35 pikë = mjaftueshëm.
 - Më pak se 30 pikë = i pamjaftueshëm.
8. Juria harton Raportin e Vlerësimit të Doktoratës. Raporti përmban vlerësimin e elementëve të caktuar të disertacionit, sipas modelit të parashikuar në procedurën operacionale DKSHP 01.07.00 (Procedura operacionale e fitimit të gradës shkencore “Doktor” në UPT). Vlerësimi përfundimtar shpallet nga Kryetari i Jurisë në përfundim të mbrojtjes së disertacionit.
 9. Juria, brenda 3 (tre) ditëve nga mbrojtja e disertacionit, përcjell në KP, Raportin e Vlerësimit së bashku me dosjen përkatëse të vlerësimit.
 10. Kur raporti i vlerësimit të Jurisë është negativ (disertacioni vlerësohet me më pak se 30 pikë), ajo duhet të argumentojë me shkrim vlerësimin negativ dhe t’ a përfshijë atë si pjesë të këtij raporti.

Neni 18

Marrja e diplomës për gradën shkencore “Doktor”

1. Këshilli i Profesorëve, brenda 10 (dhjetë) ditëve merr vendimin për dhënien ose jo të gradës shkencore “Doktor”, dhe ia përcjell dosjen drejtuesit të njësisë kryesore, për procedura të mëtejshme.
2. KP-ja merr vendim për dhënien e gradës shkencore “Doktor” kur:
 - Konstaton respektimin e procedurave të ndjekura nga Juria;
 - Vlerësimi i Jurisë është pozitiv.
3. KP-ja merr vendim për mosdhënien e gradës shkencore “Doktor” nëse vlerësimi i Jurisë është negativ.
4. Në rast të konstatimit të mos respektimit të procedurave të ndjekura nga Juria, KP ia kthen Jurisë për rishqyrtim.
5. Drejtuesi i njësisë kryesore, me shkresë zyrtare, brenda 1 (një) jave e përcjell Vendimin e KP-së për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Rektoratin e UPT-së dhe kërkon regjistrimin e gradës në Regjistrin e UPT-së dhe në atë shtetëror të gradave dhe titujve akademikë.
6. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë përcillet nga UPT në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e saj të vartësisë, për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.
7. Pas regjistrimit në regjistrin e UPT-së dhe në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, lëshohet diploma përkatëse, sipas formatit të miratuar në SAUPT. Numri i regjistrimit i përcillet njësisë kryesore përkatëse.
8. Para regjistrimit, kopje elektronike dhe të printuara të disertacionit të studentit që ka marrë gradën shkencore “Doktor”, depozitohen në Bibliotekën Shkencore të UPT-së dhe në Bibliotekën Kombëtare. Kopje elektronike e disertacionit publikohet në faqen zyrtare të UPT-së.
9. Njësia kryesore, përgatit Diplomën e Gradës Shkencore “Doktor”, e cila hartohet në përputhje me formatin e miratuar dhe firmoset nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe nga Rektori i UPT-së.

Neni 19

Transferimi i studimeve në programin e doktoratës

1. Njësia bazë/kryesore, në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë, përcakton kriteret specifike që kandidati duhet të plotësojë për të transferuar studimet në programin e studimit sipas fushës së kërkimit.
2. Transferimet bëhen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë se fundi i javës së pestë të semestrit të parë. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të studimit të doktoratës, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kriteret pranimit që njësia bazë/kryesore ka përcaktuar për pranimin e studentëve në vitin përkatës të referencës. Kriteret të cilat bëhen publike paraprakisht. Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin IAL, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, po në nivelin 8 të KSHK, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara nga institucioni. Kuotat në dispozicion për transferimin e studentëve nga IAL të tjera ose brenda së njëjtës IAL, përbëhen nga kuotat e paplotësuara nga regjistrimet e vitit të mëparshëm dhe kapacitetet që mund të krijohen, si rezultat i çregjistrimit të studentëve gjatë vitit akademik.

Neni 20

Pezullimi dhe ndërprerja e programit të studimeve të doktoratës

1. Doktoranti, për arsye objektive, mund të kërkojë ndërprerjen e përkohshme të studimeve të doktoratës, për një afat maksimal deri në një vit.
2. Procedura e doktoratës pezullohet kur udhëheqësi shkencor jep dorëheqjen në rastet e pamundësisë së kryerjes të këtij funksioni si dhe kur rezultatet e arritura nga doktoranti nuk kanë përmbushur kërkesat dhe objektivat e përcaktuara në programin kërkimor të miratuar, pavarësisht punës së udhëheqësit, dhe që nuk garantojnë vazhdimin e suksesshëm të projektit kërkimor të miratuar në përmbushje të kriterëve akademike të përcaktuara.
3. Ndërprerja e studimeve të doktoratës dhe çregjistrimit nga ky program në rastet kur:
 - a. Kandidati në mënyrë të vullnetshme heq dorë nga vazhdimi i studimeve.
 - b. Konstatohen sjellje të rënda dhe të përsëritura kundër standardeve të etikës kërkimore, pasi të jenë ndjekur procedurat e përcaktuara në aktet rregullatore në fuqi.
 - c. Konstatohet më pas në kohë, se kandidati nuk ka plotësuar kriteret për pranimit të ecurisë në programin përkatës të doktoratës dhe parregullsi të tjera të procesit.
 - d. Kalon kohëzgjatja maksimale e përcaktuar për përfundimin e programit të doktoratës dhe nuk ka pasur kërkesë nga kandidati, për shtyrjen ose pezullimin e afatit.
4. Në rast se doktoranti, nuk arrin të përfundojë studimet apo i ndërpre ato brenda afatit të caktuar, ai mund të pajiset me vërtetim për rezultatet e arritura.
5. Vërtetimi lëshohet nga drejtuesi i njësisë kryesore, pas mendimit të drejtuesit të njësisë bazë në lidhje me rezultatet dhe arritjet e studentit, rezultate të cilat konfirmohen nga KP-ja, bazuar mbi të dhënat në dosjen e studentit.

Neni 21

Revokimi i gradës shkencore “DOKTOR”

Grada shkencore “Doktor” është e revokueshme në çdo kohë dhe për çdo rast, kur konstatohet plagjiaturë, sipas përcaktimeve në Kodin e Etikës së UPT-së.

Grada shkencore “Doktor” mund të anulohet në rastet kur vërtetohet se, në veprimtarinë shkencore, që ka shërbyer për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, konstatohen sjellje dhe praktika të papranueshme, në kundërshtim me parimet e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, konkretisht:

- a. Fabrikim – sajim i rezultateve dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta;
- b. Falsifikim - manipulim i materialeve të kërkimit, pajisjeve apo proceseve ose ndryshimi, heqja apo shmangia e të dhënave apo rezultateve pa justifikim;
- c. Plagjiaturë - përdorim i ideve dhe punës së të tjerëve pa ia njohur vlerën burimit original, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale sukurse përcaktohet në Kodin e Etikës në UPT.


Neni 22

Dispozita të fundit dhe kalimtare

1. Kjo rregullore zbatohet për kandidatët të cilët janë regjistruar në programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”, pas hyrjes në fuqi të VKM 128, datë 6. 3. 2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 112, datë 23.2.2028, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’, të ndryshuar”.
2. Kandidatët e regjistruar në programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” përpara hyrjes në fuqi të VKM 128, datë 6.3.2024, të regjistruar për herë të parë në vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024, përmbushin kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në momentin e regjistrimit në programin e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës.

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 34, datë 26.06.2025.



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 1 nga 22 Kopje nr: 1	

PROCEDURA OPERACIONALE E VERIFIKIMIT ANTI-PLAGJIATURË TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Kodi: DKSHP.01.02.00

Botim: 2, Rishikim: 2




Universiteti Politeknik i Tiranës

Sheshi "Nënë Tereza",4

Tiranë, ALBANIA

Tel: +355 4 2227914


Web: upt.edu.al

	Procedura Operacionale	Botim: 2	Nr. i
	Kodi: DKSHP 01.02.00	Rishikim: 2	kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 2 nga 22	
		Kopje nr: 1	

PËRMBAJTJA

- 1 Lista e personave përgjegjës në përpunimin, verifikimin dhe miratimin e botimit/rishikimit të procedurës
- 2 Situata e botimit dhe e rishikimit të procedurës operacionale
- 3 Lista e personave të cilëve i'u dorëzohet botimi/rishikimi i procedurës
- 4 Shpjegime dhe shkurtime të termave të përdorur në procedurën e formalizuar
- 5 Përmbajtja e procedurës
 - 5.1 Qëllimi i procedurës
 - 5.2 Fusha e zbatimit të procedurës
 - 5.3 Dokumentacioni referues në hartimin e procedurës
 - 5.3.1 Legjislacion bazë
 - 5.3.2 Rregullore të brendshme
 - 5.4 Përshkrimi i procedurës
 - 5.4.1 Përmbledhje
 - 5.4.2 Përshkrimi i etapave të zhvillimit të aktivitetit bazë të procedurës
 - 5.4.3 Burimet e nevojshme
 - 5.5 Kuptimi i ngjashmërisë
 - 5.5.1 Përcaktimi i përqindjes së ngjashmërisë
 - 5.5.2 Kontrolli digjital i origjinalitetit me disertacion në gjuhën shqipe
 - 5.5.3 Kufizimet e modalitetit "Translated Matching"
 - 5.5.4 Vlerësimi i origjinalitetit
 - 5.6 Përcaktimi i përgjegjësive në zhvillimin e aktiviteteve gjatë procedurës
- 6 Flowcharti i procedurës
- 7 Arkivimi i procedurës
- 8 Formularët e përdorur në zbatimin e procedurës
- 9 Aneks




	Procedura Operacionale	Botim: 2	Nr. i
	Kodi: DKSHP 01.02.00	Rishikim: 2	kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 3 nga 22	
			Kopje nr: 1

1 Lista e personave përgjegjës në përpunimin, verifikimin dhe miratimin e botimit/rishikimit të procedurës

Bot.	Rish.	Punuar	Verifikuar	Këshilluar/Njoftuar	Njoftim i ligjshmërisë	Aprovuar/Miratuar
		Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve	Drejtoria e Kërkimit dhe Projekteve	Rektorati UPT	Spektori Juridik	Autoriteti drejtues i Institucionit
		Spektori i Promovimit Akademik dhe Shkencor	Drejtor	Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor	Përgjegjëse e Spektorit	Rektori
2	1	Uriana Thanasi	Prof. Dr. Aida Spahiu	Prof. Asoc. Elfrida Shehu	Donika Qafa	Prof. Dr. Andrea Maliqari
2	2	Uriana Thanasi	Prof. Dr. Elson Agastra	Prof. Dr. Elfrida Shehu	Donika Qafa	Prof. Dr. Akli Fundo




	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 4 nga 22	
		Kopje nr: 1	

2 Situata e botimit dhe e rishikimit të procedurës operacionale

Nr.	Botimi	Rishikimi	Përbërësi i rishikuar/shtuar	Metoda e rishikimit/shtimit	Data	Firma/Aprovimi
1	2	1	Aktiviteti A i procedurës. Udhëzuesi i përdorimit për vlerësuesin. Udhëzuesi i përdorimit për kandidatin doktorant.	Hiqet aktiviteti A për shkak të përfundimit të afateve të parashikuara. Shtohen udhëzime sqarues për shkak të përdorimit te platformës Akademia, Crossplag.	1.09.2021	
2	2	2	Paragrafi 5.5 – kuptimi i ngjashmërisë në përputhje me platformën digjitale "Turnitin"	Shtohet mënyra e vlerësimit digjital për disertacione me mbi 150,000 karaktere. Shtohet koncepti i origjinalitetit dhe vlerësimit digjital. Shtohen udhëzime për përdorimin e platformës Turnitin. Shtohet Formulari për Komisionin ad-hoc.	26.6.2025	




	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 5 nga 22 Kopje nr: 1	

3 Lista e personave të cilëve i'u dorëzohet botimi/rishikimi i procedurës

Qëllimi	Mënyra e shpërndarjes	Kopje Nr.	Struktura	Funksioni	Emër/ Mbiemër	Data e shpërndarjes
Faktim dhe aplikim	Ekzemplari original	1	Rektorati UPT	Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor	Prof. Dr. Elfrida Shehu	
Faktim, aplikim, arkivim	Ekzemplari original	2	Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve	Drejtori	Prof. Dr. Elson Agastra	
Aplikim	Ekzemplar në format elektronik dhe kopje hard copy	1	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	Dekani		
		1	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Dekani		
		1	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Dekani		
		1	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Dekani		
		1	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Dekani		
		1	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Dekani		
		1	Fakulteti Inxhinierisë Elektrike	Dekani		
		1	Instituti i Gjeoshkencave	Drejtori		
Informim	Kopje hard copy	1	Bordit të Administrimit	Administratorit të UPT-së		
Informim	Ekzemplar në format elektronik	1	www.upt.edu.al	Të gjithë		




	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 6 nga 22	
		Kopje nr: 1	

4 Shpjegime dhe shkurtime të termave të përdorur në procedurën e formalizuar

Nr.	Termi	Shpjegimi
1	Kërkim Shkencor	Puna krijuese e ndërmarrë dhe e realizuar në mënyrë sistematike, që ka për qëllim shtimin dhe zhvillimin e njohurive shkencore.
2	Doktoratë	Gradë akademike e cila jepet nga universitetet dhe e cila në shumicën e vendeve, është një gradë hulumtuese, kërkimore dhe shkencore përmes së cilës bartësi i saj kualifikohet për mësimdhënie në nivelin universitar ose në një fushë specifike të profesionit.
3	Fabrikimi	Sajimi i rezultateve të kërkimit dhe regjistrimi i tyre sikur te ishin të vërteta.
4	Falsifikimi	Manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit, ndryshimi, heqja ose shmangia e të dhënave ose e rezultateve, në mënyrë të pa justifikuar.
5	Plagjiatura	Përdorimi i ideve dhe punës se te tjerëve si te vetat, pa cituar burimin origjinal, duke shkelur te drejtat e autoreve dhe produktet e tyre origjinale.
6	Verifikim anti-plagjiaturë	Veprimi i kontrollit të punimeve të studimeve shkencore-akademike për të konstatuar përputhjen me standardet dhe normat e etikës dhe integritetit akademik.
7	Program anti-plagjiaturë	Software për identifikimin e ngjashmërive të tekstit.

Shkurtimi	Termi i shkurtuar
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës
DKSHP	Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve
BA-UPT	Bordi i Administrimit i Universitetit Politeknik të Tiranës



	Procedura Operacionale	Botim: 2	Nr. i
	Kodi: DKSHP 01.02.00	Rishikim: 2	kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 7 nga 22	
		Kopje nr: 1	

5 Përmbajtja e procedurës

5.1 Qëllimi i procedurës

Qëllimi i kësaj procedure është:

- Përcaktimi i mënyrës dhe rrugës operacionale të verifikimit të origjinalitetit dhe përputhshmërisë së disertacioneve për fitimin e gradës shkencore "Doktor".
- Evidentimi i përgjegjësive të aktorëve të përfshirë në verifikimin anti-plagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradës shkencore "Doktor".
- Sigurimi i nivelit optimal të origjinalitetit dhe përputhshmërisë të disertacioneve për fitimin e gradës shkencore "Doktor".
- Sigurimi i vlerave etike dhe integritetit akademik/shkencor në studimet e doktoratës në UPT.

5.2 Fusha e zbatimit të procedurës

Procedura në fjalë është një procedurë operacionale e cila aplikohet në aktivitetin akademik/shkencor të çdo njësie bazë dhe njësie kryesore, në përputhje me kërkesat specifike dhe legjislacionin në fuqi.

5.3 Dokumentacioni referues në hartimin e procedurës


5.3.1 Legjislacion bazë

- Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 777, datë 26.12.2018 "Për kontrollin anti-plagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore" i ndryshuar;

5.3.2 Rregullore të brendshme

- Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës;
- Kodi i Etikës së Universitetit Politeknik të Tiranës;
- Rregullore e Studimeve të Doktoratës së Universitetit Politeknik të Tiranës;
- Rregullore e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" e Universitetit Politeknik të Tiranës.



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 8 nga 22 Kopje nr: 1	

5.4 Përshkrimi i procedurës

5.4.1 Përmbledhje

Referuar Kodit të Etikës së Universitetit Politeknik të Tiranës:

- 1) Plagjiatura është përdorimi i fjalëve, ideve, koncepteve ose të dhënave të një personi tjetër, pa e cituar atë. Plagjiatura përfshin përdorimin e drejtpërdrejtë dhe parafrazimin e fjalëve, mendimeve apo koncepteve të tjetrit si të tuat, pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.

Ajo përfshin, por nuk kufizohet në:


- a) Kopjimin e paragrafëve apo pjesëve nga veprat elektronike dhe/ose kopje të punimeve, pa cituar në mënyrë të plotë e të saktë autorët dhe punimet e tyre të përdorura e për hartimin e punimeve kërkimore dhe botimet që përfshijnë kumtesa, referate, artikuj shkencorë, disertacione, monografi, tekste mësimore, manuale, teza të paraqitura për marrjen e diplomës "Master i shkencave";
 - b) Përdorimin pa treguar të pikëpamjeve, mendimeve apo njohurive të një personi tjetër.
- 2) Shmangia e plagjiaturës akademike shërben për të rritur cilësinë në kërkim e krijimtari shkencore. Kërkuesi është i detyruar të citojë në mënyrë të plotë e të saktë autorët dhe punimet e tyre, të cilat i ka konsultuar si burime të para apo burime dytësore dhe i ka përdorur për t'u informuar në lidhje me rezultatet e mëparshme apo për të argumentuar dhe interpretuar rezultatet e veprimtarisë kërkimore.

5.4.2 Përshkrimi i etapave të zhvillimit të aktivitetit bazë të procedurës

1. Verifikimi anti-plagjiaturë për punimet e doktoratës:

- Me propozim të drejtuesit të njësisë kryesore caktohet një person përgjegjës në rang fakulteti për verifikimin anti-plagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradës shkencore "Doktor", pjesë e kompetencës së asaj njësie kryesore.
- Personi përgjegjës (vlerësuesi) trajnohet për përdorimin e platformës digjitale të vlerësimit të origjinalitetit (Turnitin - FeedBack Studio, Originality Check & Translated Matching) me ndihmën e Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në UPT.
- Për verifikimin anti-plagjiaturë personi përgjegjës ka qasje në sistemin elektronik (softuer) të vlerësimit të origjinalitetit të vënë në dispozicion.
- Udhëheqësi i kandidatit doktorant dorëzon tek drejtuesi i njësisë kryesore, kopjen elektronike të disertacionit të kandidatit, një kërkesë për vlerësim të origjinalitetit dhe përputhshmërisë të nënshkruar nga ai dhe kandidati



	Procedura Operacionale	Botim: 2	Nr. i
	Kodi: DKSHP 01.02.00	Rishikim: 2	kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 9 nga 22	
		Kopje nr: 1	


doktorant (**Formulari 01.02.02**) si dhe Deklaratën e Ngjashmërisë (**Formulari 01.02.01**) të plotësuar nga kandidati doktorant.

- Kandidatët doktorantë të cilët nuk janë personel akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës, duhet të dorëzojnë së bashku me deklaratat sa më sipër edhe faturën e pagesës së përdorimit të platformës për detektimin antiplagjiaturë të disertacionit të tyre, sipas tarifës së përcaktuar nga BA-UPT.
 - Brenda 5 ditë pune, drejtuesi i njësisë kryesore, me propozim të drejtuesit të njësisë bazë, ngre një komisioni *ad-hoc* për vlerësimin e raportit digjital të origjinalitetit të disertacionit. Komisioni përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, personel akademik të njësisë bazë/kryesore të përkatësisë, bazuar fushën e kërkimit shkencor të kandidatit dhe në respektimin e hierarkisë akademike. Anëtarët duhet të kenë minimalisht gradën shkencore Doktor. Një nga anëtarët e këtij komisioni është edhe udhëheqësi shkencor i doktoratës.
 - Personi përgjegjës (vlerësuesi), brenda pesë ditëve, fton anëtarët e komisionit *ad-hoc* të ngarkojnë disertacionin në platformë dhe marrjen e raportit elektronik të vlerësimit digjital antiplagjiaturë.
 - Rezultati i disponuar nga sistemi i detektimit për disertacionin së bashku me **Formularin 01.02.03**, do të dorëzohet zyrtarisht tek drejtuesi i njësisë kryesore nga personi përgjegjës brenda 1 dite pune dhe është pjesë e dosjes së kandidatit doktorant.
 - Brenda pesë ditëve Komisioni *ad-hoc* shqyrton rezultatin e disponuar nga sistemi i detektimit anti-plagjiaturë dhe del me një raport dhe vlerësim mbi origjinalitetin e punimit të disertacionit (**Formularit 01.02.04**). Materiali i cili i dorëzohet drejtuesit të njësisë bazë/kryesore, dhe bëhet pjesë e vlerësimit të dosjes së kandidatit në njësinë bazë të përkatësisë.
2. Verifikimi anti-plagjiaturë për punimet e doktoratës në rastet kur është i pamundur realizimi i procesit të vlerësimit anti-plagjiaturë të disertacionit nga njësitë kryesore

UPT kryen në nivel institucioni, zëvendësimin e përkohshëm të vlerësuesit/vlerësuesve në njësitë kryesore kur, për arsye objektive ose për arsye të konfliktit të interesit ata e kanë të pamundur realizimin e procesit të vlerësimit anti-plagjiaturë të disertacionit pranë njësisë së tyre kryesore.

- Rektori cakton një person përgjegjës në rang UPT për verifikimin digjital anti-plagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradës shkencore "Doktor".
- Personi përgjegjës trajnohet për përdorimin e platformës "Turnitin" dhe moduleve përkatëse;




	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2	Nr. i kopjeve 2
		Rishikim: 2	
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 10 nga 22	
		Kopje nr: 1	

- Për verifikimin anti-plagjiaturë personi përgjegjës ka qasje në sistemin elektronik (softuer) të vlerësimit të origjinalitetit të vënë në dispozicion.
- Udhëheqësi i kandidatit doktorant dorëzon tek drejtuesi i njësisë kryesore, kopjen elektronike të disertacionit të kandidatit, një kërkesë për vlerësim të origjinalitetit dhe përputhshmërisë të nënshkruar nga ai dhe kandidati doktorant (**Formulari 01.02.02**) si dhe Deklaratën e Ngjashmërisë (**Formulari 01.02.01**) të plotësuar nga kandidati doktorant.
- Brenda 5 ditë pune, drejtuesi i njësisë kryesore, me propozim të drejtuesit të njësisë bazë, ngre një komisioni ad-hoc për vlerësimin e raportit digjital të origjinalitetit të disertacionit. Komisioni përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, personel akademik të njësisë bazë/kryesore të përkatësisë, bazuar fushën e kërkimit shkencor të kandidatit dhe në respektimin e hierarkisë akademike. Anëtarët duhet të kenë minimalisht gradën shkencore Doktor. Një nga anëtarët e këtij komisioni është edhe udhëheqësi shkencor i doktoratës.
- Drejtuesi i njësisë kryesore, brenda 2 ditëve pune nga ngritja e komisionit ad-hoc, përcjell zyrtarisht në Rektorat kërkesën për vlerësim të origjinalitetit dhe përputhshmërisë së bashku me:
 - ✓ Argumentimin se përse ky vlerësim nuk mund të realizohet pranë njësisë kryesore.
 - ✓ Kopjen elektronike të disertacionit të kandidatit (CD/USB).
 - ✓ Listën emërore të anëtarëve të komisionit ad-hoc për vlerësimin e raportit digjital të origjinalitetit të disertacionit.
- Personi përgjegjës në rang UPT (vlerësuesi), brenda pesë ditëve, fton anëtarët e komisionit ad-hoc të ngarkojnë disertacionin në platformë dhe marrjen e raportit elektronik të vlerësimit digjital antiplagjiaturë.
- Rezultati i disponuar nga sistemi i detektimit për disertacionin së bashku me **Formularin 01.02.03** do të përcillet zyrtarisht tek drejtuesi i njësisë kryesore nga personi përgjegjës në rang UPT brenda 3 ditëve pune dhe është pjesë e dosjes së kandidatit doktorant.
- Brenda pesë ditëve Komisioni ad-hoc shqyrton rezultatin e disponuar nga sistemi i detektimit anti-plagjiaturë dhe del me një raport dhe vlerësim mbi origjinalitetin e punimit të disertacionit (**Formularit 01.02.04**). Materiali i cili i dorëzohet drejtuesit të njësisë bazë/kryesore, dhe bëhet pjesë e vlerësimit të dosjes së kandidatit në njësinë bazë të përkatësisë.

5.4.3 Burimet e nevojshme

- 1) Burime materiale



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2	Nr. i
		Rishikim: 2	kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 11 nga 22	
		Kopje nr: 1	

- UPT disponon bazën materiale për zhvillimin e aktivitetit të verifikimit anti-plagjiaturë: platforma digjitale të vlerësimit të origjinalitetit (Turnitin - FeedBack Studio, Originality Check & Translated Matching);
- Për zhvillimin e aktiviteteve të cilat janë pjesë e specifikave të kësaj procedure nuk janë të nevojshme burime materiale ose pajisje speciale, veç atyre të përdorimit të përditshëm zyrtar: kompjuter, printer multifunksional, tavolinë, karrige, etj.;
- Në kushtet në të cilat do të konstatohet nevoja e disa pajisjeve specifike, kjo nevojë do t'i adresohet eprorëve të institucionit në formën e një kërkesë me shkrim.

2) Burime njerëzore

- Personel i cili mund të bashkëveprojë me aktivitetin e procedurës,
- Personat përgjegjës për përdorimin e platformës antiplagjiaturë (vlerësuesit),
- Anëtarë të komisionit për verifikimin antiplagjiaturë,
- Drejtoria Kërkimit Shkencor dhe Projekteve,
- Udhëheqësit shkencor të studentëve doktorant,
- Drejtuesit e njësive bazë,
- Drejtuesit e njësive kryesore,
- Komisionet e përhershme për dhënien e gradës shkencore "Doktor",
- Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor,
- Rektori,


3) Burime financiare

- Buxheti vjetor i aprovuar për institucionin i cili do të përdoret për blerjen periodike të platformës antiplagjiaturë.
- Për kandidatët doktorantë të cilët nuk janë personel akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës, përdorimi i platformës për detektimin antiplagjiaturë të disertacionit të tyre, do të mbulohet nga vetë ata, sipas tarifës së përcaktuar nga BA-UPT.

5.5 Kuptimi i ngjashmërisë

Raporti elektronik i ngjashmërisë paraqet një përmbledhje të detajeve të ngjashmërisë mes tekstit në disertacion dhe atij në burimet e tjera, duke vënë në



	Procedura Operacionale	Botim: 2	Nr. i
	Kodi: DKSHP 01.02.00	Rishikim: 2	kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 12 nga 22	
		Kopje nr: 1	

dukje pjesët e tekstit në disertacion që përputhen me ato në burimet e tjera dhe duke i referuar ato për krahasim.

5.5.1 Përcaktimi i përqindjes së ngjashmërisë

Vlerësimi digjital/elektronik i disertacionit është një instrument ndihmës për vlerësimin e origjinalitetit të tij.

Raporti elektronik i vlerësimit të origjinalitetit paraqet në formë përqindjeje ngjashmërinë e disertacionit me burimet e tjera si: periodikë, revista, publikime të tjera dhe faqe në internet.

Përqindja e ngjashmërisë së disertacionit me burimet e tjera vlerësohet si, raporti i numrit të fjalëve të tekstit të ngjashëm në disertacion me burimet e tjera, kundrejt numrit total të fjalëve që disertacioni ka¹.

Vlerësimi elektronik i origjinalitetit të disertacionit nuk përcakton vetë plagjiaturën e tij, por realizon një krahasim me burime të dhënash nga periodikë, revista dhe publikime të tjera, si dhe faqe në internet. Nëse në disertacion gjendet tekst i ngjashëm me një burim tjetër, ai shënohet në raport dhe rrit përqindjen përkatëse të ngjashmërisë.

Një raport ngjashmërie mund të tregojë vetëm nëse fragmente ose blloqe teksti të ngjashme janë shfaqur në disertacion, por jo nëse janë përdorur saktë duke i'u referuar burimit origjinal, apo në përputhje me kodin e etikës në përdorimin e burimeve të informacionit.


Është detyrë e komisionit ad-hoc të analizojë raportin e vlerësimit digjital të disertacionit dhe të dalë në përfundime të përputhshmërisë së origjinalitetit.

5.5.2 Kontrolli digjital i origjinalitetit me disertacion në gjuhën shqipe

Konteksti i kërkimit shkencor, nuk është i kufizuar në gjuhën shqipe, kështu që edhe kontrolli elektronik i ngjashmërisë nuk mund të jetë i kufizuar vetëm me materiale në gjuhën shqipe.



¹ Source: <https://guides.turnitin.com/hc/en-us/articles/23713493434253-Understanding-the-similarity-score-for-students> [... The similarity score is the percentage of matched text your submission contains, or overall similarity. We calculate this by dividing the total words in a submission by the amount of words matched to outside sources. ...]

	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2	Nr. i
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Rishikim: 2	kopjeve 2
		Faqe 13 nga 22	
		Kopje nr: 1	

Sistemi elektronik i vlerësimit të origjinalitetit (Turnitin, që përdoret në Universitetin Politeknik të Tiranës), mundëson në mënyrë automatike kontrollin e ngjashmërisë të disertacioneve në gjuhën shqipe si dhe duke i përshtatur ato automatikisht në gjuhën angleze me funksionalitetin "*Translated Matching*".

"*Translated Matching*" është një shërbim i ofruar nga Turnitin, që lejon kontrollin e disertacioneve të hartuara në gjuhë të ndryshme nga ajo angleze, dhe mundëson krahasimin me përmbajtje të botimeve në gjuhën angleze (Originality Check). Edhe për këtë modalitet platforma harton raportin përkatës të ngjashmërisë, nëse gjen përputhshmëri mes materialit që vlerësohet dhe periodikëve, revistave, botimeve të tjera, apo faqeve në internet.

5.5.3 Kufizimet e modalitetit "*Translated Matching*"

Modaliteti "*Translated Matching*" vlerëson gjuhën e punimit dhe më pas e përshtat atë automatikisht në gjuhën angleze. Materiali kështu i përshtatur, krahasohet për ngjashmëri.


Ky modalitet paraqet një kufizim në madhësinë e skedarit të përdorur për vlerësim. Përkatësisht, madhësia maksimale e skedarit nuk duhet të jetë më shumë se 150,000 karaktere apo rreth 25,000 fjalë. Skedarë që tejkalojnë këtë limit, nuk përshtaten në gjuhën angleze, dhe kështu nuk realizohet kontrolli i origjinalitetit në këtë gjuhë.

Për të tejkaluar këtë kufizim, disertacioni i përdorur për fitimin e gradës shkencore "Doktor", për kontrollin digjital anti-plagjiaturë, për disertacionet që e tejkalojnë limitin e 150,000 karaktere vepohet:

1. Disertacioni ndahet në dy apo më shumë skedarë, madhësia e secilit prej tyre, nuk i tejkalon 150,000 karaktere.
2. Ndarja e disertacionit realizohet në seksione logjike si fund kapitulli apo fund seksionesh, kur është e mundur.
3. Secili skedar vlerësohet veçmas në platformën digjitale Turnitin.
4. Platforma Turnitin harton së paku raportin e ngjashmërisë për përputhshmërinë e skedarëve origjinal në gjuhën shqipe, dhe më pas, nëse gjen ngjashmëri në gjuhën angleze, harton edhe raportin elektronik përkatës për ngjashmërinë në gjuhën angleze.

Kjo platformë mund të hartojë dy raporte ngjashmërie, një në gjuhën origjinale të punimit (gjuha shqipe) dhe një në atë angleze, të realizuar me modalitetin automatik "*Translated Matching*".



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 14 nga 22	
		Kopje nr: 1	

Komisioni *ad-hoc*, bazuar në mënyrën e vlerësimit dhe llogaritjes së përqindjes së ngjashmërisë nga platforma Turnitin², mund të përdori shprehjen vijuese për përcaktimin e nivelit të ngjashmërisë bruto të disertacionit, bazuar në raportet e ngjashmërisë bruto të skedarëve individualë.

$$S = \frac{\sum_f^F (P_f^{AL} + P_f^{EN}) \times N_f}{\sum_f^F N_f}$$

Ku:

- S** : Ngjashmëria e disertacionit në "%";
F : Numri i skedarëve në të cilët është ndarë disertacioni;
f : Skedar numër *f* që përbën disertacionin;
P_f^{AL} : Ngjashmëria në "%" i skedarit *f* në kontroll në gjuhën shqipe;
P_f^{EN} : Ngjashmëria në "%" i skedarit *f* në kontroll në gjuhën angleze duke përdorur "Translated Matching", nëse është hartuar;
N_f : Numri i fjalëve të skedarit *f* sipas vlerësimit në raport nga platforma Turnitin.

Shembull zbatimi i formulës së më sipërme për një disertacion të ndarë në 3 skedarë:

Nr. skedari (<i>f</i>)	Nr. Faqe skedari	Numri i fjalëve të skedarit <i>f</i> (<i>N_f</i>)	Ngjashmëria në gjuhën shqipe (<i>P_f^{AL}</i>)	Ngjashmëria në gjuhën angleze (<i>P_f^{EN}</i>)
1	88	23,503	13 %	2 %
2	38	11,784	12 %	0 %
3	56	20,533	6 %	0 %
Total	182	55,820	11 %³	

5.5.4 Vlerësimi i origjinalitetit

Komisioni *ad-hoc* i cili bazuar në raportin elektronik të origjinalitetit, përcakton nëse disertacioni është në përputhje me përcaktimet ligjore të anti-plagjiaturës, duke pasur në konsideratë:


- Një përqindje e lartë e ngjashmërisë, nuk vërteton plagjiaturën e disertacionit, dhe një përqindje e ulët nuk përjashton mundësitë e saj.
- Dy disertacione me ngjashmëri të afërt (p.sh. 20% vs 22%) mund të jenë njëri

² Source: <https://guides.turnitin.com/hc/en-us/articles/23713493434253-Understanding-the-similarity-score-for-students> [... The similarity score is the percentage of matched text your submission contains or overall similarity. We calculate this by dividing the total words in a submission by the amount of words matched to outside sources. ...]

³ Ngjashmëria e këtij disertacioni, i ndarë në tre skedarë, vlerësohet:

$$S = \frac{(13\% + 2\%) \times 23503 + (12\% + 0\%) \times 11784 + (6\% + 0\%) \times 20533}{23503 + 11784 + 20533} = \frac{617151}{55820} = 11\%$$



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2	Nr. i
		Rishikim: 2	kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 15 nga 22	
		Kopje nr: 1	

me citime të duhura, tjetri jo; interpretimi i përqindjes së ngjashmërisë është detyrë e komisionit *ad-hoc*, dhe vlerësimit të njësisë bazë të përkatësisë.


- Ngjashmëria e disertacionit, me publikimet e vetë autorit, të realizuara në kontekstin e doktoratës, kërkojnë vlerësim në kontekstin e anti-plagjiaturës.
- Interpretimi duhet të jetë i kujdesshëm dhe me vlerësim nga komisioni *ad-hoc*.


Komisioni *ad-hoc*, në përmbyllje të procesit të vlerësimit të origjinalitetit, bazuar në raportin elektronik të gjeneruar nga platforma turnit-in, del me një raport vlerësimi origjinaliteti i cili bëhet pjesë e vlerësimit të njësisë bazë të përkatësisë dhe shtohet në dosjen e kandidatit.

5.6 Përcaktimi i përgjegjësive në zhvillimin e aktiviteteve gjatë procedurës

Për qëllimet e kësaj procedure operacionale, në vijim paraqiten përgjegjësitë e aktorëve kryesorë të përfshirë në këtë proces, por që nuk kufizohet vetëm në:

- **Drejtuksi i njësisë kryesore** - ka përgjegjësi për:
 - Caktimin, me objektivitet dhe në përputhje me kriteret e legjisllacionit në fuqi, të personit përgjegjës për verifikimin anti-plagjiaturë të disertacionit të doktoratës (vlerësuesi).
 - Vlerësimin e situatës në rastet kur është i pamundur realizimi i procesit të vlerësimit anti-plagjiaturë të disertacionit nga njësia kryesore përkatëse dhe përgatitjen e argumentimit për këtë rast. Përcjelljen zyrtare në Rektorat të kërkesës për vlerësim të origjinalitetit dhe përputhshmërisë së bashku me dokumentacionin e plotë përkatës.
- **Personi përgjegjës (vlerësuesi në rang njësie kryesore) për verifikimin anti-plagjiaturë të disertacionit të doktoratës** - ka përgjegjësi për:
 - Trajnimin dhe aftësimin e plotë dhe të rregullt për përdorimin e platformës "Turnitin" dhe moduleve përkatëse;
 - Ngarkimin e disertacionit në platformën digjitale në prani të anëtarëve të komisionit *ad-hoc*;
 - Qëndrimin e rregullt dhe me integritet në nxjerrjen e rezultatit nga sistemi i detektimit anti-plagjiaturë dhe dorëzimin zyrtar të dokumentit përkatës tek komisioni *ad-hoc* dhe te drejtuesi i njësisë kryesore në kohën e duhur;
 - Mbajtjen me korrektësi të evidencës në lidhje me dokumentin anti-plagjiaturë të lëshuar prej tij dhe plotësimit të **formularit 01.02.03**.



	Procedura Operacionale	Botim: 2	Nr. i
	Kodi: DKSHP 01.02.00	Rishikim: 2	kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 16 nga 22	
		Kopje nr: 1	

- **Personi përgjegjës (vlerësuesi në rang UPT)** – ka përgjegjësi për:
 - Trajnimin dhe aftësimin e plotë dhe të rregullt për përdorimin e platformës "Turnitin" dhe moduleve përkatëse;
 - Trajnimin dhe udhëzimin e vlerësuesve në njësitë kryesore për përdorimin e platformës "Turnitin" dhe moduleve përkatëse;
 - Zëvendësimin e përkohshëm të vlerësuesit/vlerësuesve në njësitë kryesore, kur për arsye objektive ata e kanë të pamundur realizimin e procesit të vlerësimit anti-plagjiaturë të disertacionit.
 - Ngarkimin e disertacionit në platformën digjitale në prani të anëtarëve të komisionit ad-hoc;
 - Mbatjen me korrektësi të evidencës në lidhje me dokumentin anti-plagjiaturë të lëshuar prej tij dhe plotësimin të **formularit 01.02.03**.
 - Qëndrimin e rregullt dhe me integritet në nxjerrjen e rezultatit nga sistemi i detektimit anti-plagjiaturë dhe dorëzimin zyrtar të dokumentit përkatës tek komisioni ad-hoc dhe te drejtuesi i njësisë kryesore në kohën e duhur.


- **Udhëheqësi i kandidatit doktorant** - ka përgjegjësi për:
 - Hartimin dhe dorëzimin e kërkesës për vlerësim të origjinalitetit dhe përputhshmërisë së disertacionit (**Formulari 01.02.02**);
 - Dorëzimin zyrtar dhe korrekt të kopjes elektronike të disertacionit të kandidatit.

- **Kandidati doktorant** - ka përgjegjësi për:
 - Përgatitjen e disertacionit në përputhje me nivelin shkencor të kërkuar dhe me kriteret e tjera të legjislacionit përkatës në fuqi;
 - Bashkëpunimin korrekt me udhëheqësin e doktoratës, në veprimet e këtij të fundit gjatë realizimit të kësaj procedure.
 - Plotësimin e Deklaratës së Ngjashmërisë (**Formulari 01.02.01**).


- **Përgjegjësi i njësisë bazë** - ka përgjegjësinë për:
 - Propozimin e komisionit të shqyrtimit të rezultatit anti-plagjiaturë të disertacionit të doktoratës, duke caktuar në të anëtarë të stafit akademik me integritet në fushën e kërkimit shkencor të punimit të doktoratës.


- **Komisioni shqyrtues i rezultatit anti-plagjiaturë të punimit të doktoratës** (komisioni ad-hoc) - ka përgjegjësi për:
 - Shqyrtimin me korrektësi dhe integritet të rezultatit anti-plagjiaturë të disertacionit të kandidatit;
 - Përpilimin e qartë, me korrektësi dhe integritet, të raportit përkatës si pjesë përbërëse e dosjes së kandidatit. (Raporti mbi gjetjen e origjinalitetit dhe përputhshmërisë së Studimit të Doktoratës (**Formulari 01.02.04**).



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operationale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 17 nga 22	
		Kopje nr: 1	

6 Flowcharti i procedurës



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2	Nr. i
		Rishikim: 2	kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 18 nga 22	
		Kopje nr: 1	

7 Arkivimi i procedurës

Një kopje origjinale e kësaj procedure arkivohet pranë arkivës së institucionit dhe një kopje e dytë arkivohet pranë DKSHP.

Periudha e ruajtjes së kopjes origjinale të arkivuar është 10 vjet. Për çdo ndryshim në procedurë, arkivohen në të dy këto vende, kopjet e modifikuara.

8 Formularët e përdorur në zbatimin e procedurës

Formulari 01.02.01 - Deklaratë origjinaliteti

Formulari 01.02.02 - Kërkesë për vlerësim të origjinalitetit dhe përputhshmërisë të studimit të doktoratës

Formulari 01.02.03 - RAPORT mbi vlerësimin digjital anti-plagjiaturë të disertacionit për fitimin e gradës shkencore "Doktor"


Formulari 01.02.04 - RAPORT mbi gjetjen e origjinalitetit dhe përputhshmërisë të disertacionit për fitimin e gradës shkencore "Doktor"

9 Aneks

Shtojca 01.02.00-1 - Udhëzues përdorimi i platformës Turnitin

Shtojca 01.02.00-2 - Udhëzues për ndarjen e disertacionit në disa skedarë



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 19 nga 22	
		Kopje nr: 1	

Formulari 01.02.01

Data _____


DEKLARATË

Unë i/e nënshkruari/a _____, kandidat doktorant pranë Fakultetit _____ në Universitetin Politeknik të Tiranës, regjistruar në Studimet e Doktoratës më datë _____, në fushën e studimit _____,

deklaroj me përgjegjësi të plotë se ekzemplari digjital i disertacionit dhënë për vlerësim origjinaliteti e përputhshmërie me qëllim verifikimin anti-plagjiaturë, është identik me ekzemplarën që do të botohet/është botuar.

Emër/Mbiemër/Firma



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 20 nga 22	
		Kopje nr: 1	

Formulari 01.02.02

Data _____

Kërkesë për vlerësim të origjinalitetit dhe përputhshmërisë të studimit të doktoratës

Unë i/e nënshkruari/a _____, kandidat doktorant pranë Fakultetit _____ në Universitetin Politeknik të Tiranës, regjistruar në Studimet e Doktoratës më datë _____, në fushën e studimit _____,


me udhëheqës shkencor _____, kërkoj nëpërmjet kësaj shkrese, që punimi im i disertacionit me temë:

t'i nënshtrohet sistemit elektronik të verifikimit anti-plagjiaturë (ekzemplari digjital i disertacionit bashkëlidhur).

Emër/Mbiemër/Firma
 (Kandidati Doktorant)

Emër/Mbiemër/Firma
 (Udhëheqësi Shkencor)



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 21 nga 22 Kopje nr: 1	

Formulari 01.02.03

Data _____

RAPORT

mbi vlerësimin digjital anti-plagjiaturë të disertacionit për fitimin e gradës shkencore "Doktor"

Fakulteti i _____

Tema e disertacionit: _____

Autor : _____

Udhëheqës Shkencor _____

Disertacioni, në formatin elektronik i përbërë nga _____ faqe, për qëllimin e vlerësimit digjital anti-plagjiaturë, u nda në _____ skedarë.

Vlerësimi i ngjashmërisë lëshuar nga sistemi i detektimit anti-plagjiaturë, për secilin skedar, tregon përqindjen e mëposhtme të ngjashmërisë.

Nr. skedari (f)	Nr. Faqe skedari	Numri i fjalëve të skedarit f (N_f) ⁴	Ngjashmëria në gjuhën shqipe (P_f^{AL})	Ngjashmëria në gjuhën angleze (P_f^{EN})
1			%	%
2			%	%
3			%	%
4			%	%
5			%	%
Total ⁵			%	

Përmbledhja e mësipërme, bashkë me raportet e lëshuara nga sistemi anti-plagjiaturë, për secilin skedar, janë pjesë e vlerësimit nga komisioni ad-hoc mbi gjetjen e origjinalitetit dhe përputhshmërisë të disertacionit për fitimin e gradës shkencore "Doktor".


Vlerësuesi: _____

⁴ Numri i fjalëve të skedarit f sipas vlerësimit në raport nga platforma Turnitin.

⁵ Ngjashmëria e këtij disertacioni, i ndarë në skedarë, vlerësohet sipas seksionit "5.5.3 Kufizimet e modalitetit "Translated Matching"" të kësaj procedure:

$$S = \frac{\sum_f^F (P_f^{AL} + P_f^{EN}) \times N_f}{\sum_f^F N_f}$$



	Procedura Operacionale Kodi: DKSHP 01.02.00	Botim: 2 Rishikim: 2	Nr. i kopjeve 2
	Procedura operacionale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës	Faqe 22 nga 22	
		Kopje nr: 1	

Formulari 01.02.04

Data _____

RAPORT

mbi gjetjen e origjinalitetit dhe përputhshmërisë të disertacionit për fitimin e gradës shkencore "Doktor"

Fakulteti i _____

Tema e disertacionit: _____

Autor : _____

Fusha e studimit: _____

Udhëheqës Shkencor : _____

Vlerësimi i ngjashmërisë lëshuar nga sistemi i detektimit anti-plagjiaturë tregon përqindjen e mëposhtme të ngjashmërisë _____

Në vijim të analizës, vlerësimi të përmbajtjes, strukturës dhe vlerave shkencore, origjinalitetit të konkluzioneve personale dhe rëndësisë së burimeve biografike, disertacioni në fjalë:

Përmbush kriteret shkencore në lidhje me origjinalitetin dhe përputhshmërinë e përmbajtjes së tij, motiv për të cilin pranohet për mbrojtje në formën e paraqitur.

Nuk përmbush kriteret shkencore në lidhje me origjinalitetin dhe përputhshmërinë e përmbajtjes së tij, motiv për të cilin refuzohet për mbrojtje në formën e paraqitur, për motivet e mëposhtme:

Komisioni *ad-hoc*:

Kryetar: _____

Anëtar: _____

Anëtar: _____



Shtojca 01.02.00-1

Udhëzues përdorimi i platformës Turnitin

1. (Figura 1) Qasje në platformën digjitale në faqen zyrtare ueb <https://www.turnitin.com/> me kredenciale institucionale të vlerësuesit;
2. (Figura 1, 2 dhe 3) Krijimi i një klase të re për secilin student doktorant që vlerësohet;
 - a. Emërtimi i klasës të përmbajë "Emër Mbiemër" të kandidatit;
 - b. Kodi i regjistrimit (*enrollment*), me 4-12 karaktere, nevojitet për shtimin e studentit në vijim, tipikisht UPT-"sigla e fakultetit";
 - c. Mbajtja shënimi e numrit identifikues të klasës dhe kodit të regjistrimit (*Class ID* dhe *Enrollment key*);
3. (Figura 5, 6, 7 dhe 8) Krijohet nga një detyrë (*assignment*) për secilin skedar përbërës të disertacionit;
 - a. Emërtohet secila detyrë me (*assignment*) "Emër Mbiemër – Sk. n nga N";
 - b. Ngarkohet një *template* me tekst që përsëritet në disertacionet në UPT, me përmbajtje si në Figurën 6;
 - c. Aktivizohet modaliteti "Translated Matching" për kontrollin edhe me materiale në gjuhën angleze;
 - d. Përfshihet teksti i bibliografisë nga gjetjet e ngjashmërisë;
4. (Figura 9) Pasi janë krijuar të gjithë detyrat për atë student, kalohet nga modaliteti "Instruktor" në atë "Student" për të mundësuar hedhjen e materialeve;
5. (Figura 10) Regjistrimi në klasën e studentit doktorant të krijuar për vlerësimin e origjinalitetit:
 - a. Kontrollohet që përdoruesi është në modalitetin student (hapi 1);
 - b. Regjistrohet në klasë (hapi 2);
 - c. Përdoren kodi i klasës dhe kodi i regjistrimit të krijuara më parë në hapin 2 më sipër.
6. (Figura 11, 12 dhe 13) Futemi në klasën e studentit për të cilin do të realizohet vlerësimi i origjinalitetit;
 - a. Hapet njëra prej detyrave;
 - b. Ngarkohet skedari PDF i disertacionit përkatës për atë detyrë;
 - c. Përsëritet procedura për secilën detyrë dhe skedar të disertacionit;
7. (Figura 14) Pasi janë ngarkuar të gjithë skedarët përbërës të disertacionit në detyrat përkatëse (kontrollohet në hapin 2), kalohet sërish në modalitetin "instruktor" (hapi 2);
8. (Figura 15 dhe 16), Instruktorit i shfaqen të gjitha detyrat që më parë ka krijuar, dhe që janë përdorur për të ngarkuar skedarët e disertacionit për vlerësimin



e origjinalitetit.

- a. Futet në detyrën përkatëse (hapi 1);
 - b. I shfaqet skedari i ngarkuar, dhe vlerësimi i origjinalitetit në gjuhën origjinale (hapi 2) dhe atë të përkthyer (hapi 3);
 - i. Nëse nuk ka shfaqje në %, është akoma duke u vlerësuar nga platforma, duhet rikontrulluar më vonë.
 - ii. Nëse i njëjti material, apo një version i më parshëm i të njëjti punim është ngarkuar më herët në platformë, kjo përqaqndje ngjashmërie mund të jetë shumë e lartë, pasi kontrollohet me vetveten,
 - iii. Në këtë rast, duhet fshirë dokumenti i parë, dhe pritur së paku 24 orë që platforma të mos e konsiderojë më si material për vlerësim.
 - iv. Kjo situatë mund të shfaqet edhe kur i njëjti material ridërgohet pas rishikimit.
 - c. Për të vlerësuar në detaje dhe shkarkuar raportin, hapet skedari i vlerësuar (hapi 4).
9. (Figura 16, 17, 18, 19 dhe 20) Vlerësimi i origjinalitetit për skedarët e ngarkuar
- a. Hapet secila detyrë për të cilën janë ngarkuar skedarë (Figura 15);
 - b. Hapet raporti i origjinalitetit (hapi 1)
 - c. Kontrollohet përqaqndje e ngjashmërisë dhe lloji i raportit të paraqitur (Standard apo ai në anglisht, hapi 4)
 - d. Për secilën tipologji raporti, shihen dhe vlerësohen burimet e përdorura në të cilat është gjendur ngjashmëri.
 - e. Secili burim ngjashmërie është i lidhur si me materialin e disertacionit ashtu edhe me materialin origjinë të kësaj ngjashmërie (hapi 6 dhe 7)
 - f. Vlerësohet e njëjta procedurë edhe për raportin në gjuhën angleze (hapi 2).
 - g. Vlerësohet nëse ngjashmëria është plagjaturë apo jo, ku dukshëm në hapin 8, është një paragraf i përshtatur nga një referencë. e cila është cituar nga doktoranti. Si e tillë është në gjykimin e komisionit ad-hoc të vlerësojë nëse ky paragraf përbën plagjaturë apo jo.
10. (Figura 20) Shkarkohet raporti i ngjashmërisë
- a. Shkarkohet raporti për vlerësimin standard
 - b. Shkarkohet raporti për vlerësimin në gjuhën angleze
11. (Figura 21 dhe 22) Raportet e shkarkuara nga platforma
- a. Për secilin skedar të disertacionit shkarkohet raporti i ngjashmërisë standard;
 - b. Për secilin skedar të disertacionit shkarkohet raporti i ngjashmërisë në gjuhën angleze;
 - c. Për secilin raport, shënohen të dhënat e numri të fjalëve dhe përqaqndje



e ngjashmërisë

12. (Figura 23) Plotësohet formulari 01.02.03 për ngjashmërinë




Figura 1: Qasje në platformën digjitale në ueb: <https://www.turnitin.com/>




Figura 2: Shtohet një klasë për secilin student doktorant.






Figura 3: Plotësimi i të dhënave të klasës




Figura 4: Krijimi i klasës me të dhënat e regjistrimit në të (Class ID dhe Enrollment key).






Figura 5: Krijimi i një detyre në klasën e studentit




Figura 6: Shembull template për tu përfshiruar nga procesi i ngjashmërisë.






Figura 7: Cilësimet e detyrës për kontrollin e origjinalitetit.




Figura 8: Cilësimet e detyrës për kontrollin e origjinalitetit, aktivizimi i modalitetit "Translated Matching".






Figura 9: Numri i detyrave për atë student, sa janë edhe skedarët e disertacionit. Kalimi nga instruktur në student.




Figura 10: Regjistrimi si student në klasën e krijuar.






Figura 11: Shfaqjen klasat ku jeni regjistruar (një klasë për secilin student).




Figura 12: Detyrat e krijuara për secilin skedar të disertacionit.






Figura 13: Ngarkimi i disertacionit apo pjesë të tij për vlerësimin e origjinalitetit.




Figura 14: Pasi ngarkohen të gjithë skedarët, kalohet nga modaliteti "student" në atë "instructor".






Figura 15: Instruktori vlerëson të gjitha detyrat (skedarët e disertacionit).




Figura 16: Skedar i vlerësuar korrektësisht nga platforma për origjinalitet.






Figura 17:




Figura 18: Kontrolli i ngjashmërisë midis disertacionit dhe materialeve të tjera.



Turnitin Assignment | Integrity | Turnitin

reports.eu.integrity.turnitin.com/#/submission-viewer/submission/turnid:2945296961594

Universiteti Politeknik i Tiranës - DKSHP
Disertacion Sk. I nga 3

Grade / 100

Similarity 2% | Flags | Feedback | Rubrics

$L = \frac{C}{V_t}$

ku V_t është vëllimi i brendshëm i tubit, m_t është masa e tubit, C është konstanta e forcës e cila varet nga madhësia dhe forma e tubit dhe është proporcionale me modulën e Young-ut të materialit të tubit.

Në analizuesin e densitetit dhe shpejtësisë së zërit, tubi është ndërtuar nga xhami borosilikat, një material që ka një ngurtësi të lartë, gjë që rezulton në një ndjeshmëri më të madhe të instrumentit krahasuar me tubat e bërë nga çeliku inox. Për shkak se vetitë mekanike të tubit varen nga temperatura dhe presioni, K dhe L duhet të përcaktohen përmes kalibrimit me një ose më shumë lëngje të cilat kanë dendësi të njohur mirë.

Ekuacioni i propozuar dhe përdorur nga prodhuesi i pajisjes për të përcaktuar densitetin është:

$$\rho = KA \times Q^2$$

ku KA dhe KB janë konstantet e pajisjes, f_1 dhe f_2 janë terma korigjues për temperaturën, dhe jo linearitetin, dhe Q është koeficienti i periudhave të oscilimit të dy tubave. Analizatori i densitetit dhe shpejtësisë së zërit përdor një oscilator referencë, i cili është gjithashtu i bërë nga xhami borosilikat, është i mbushur me një substancë të njohur referencë dhe i nënshtrohet të njëjtave kushte si oscilatori i matjes. Duke ndarë periudhën e oscilimit të celulës së matjes me periudhën e oscilimit të celulës referencë, disa efekte termike kompensohen. Korigjimi për viskozitetin është i nevojshëm sepse viskoziteti i mostrës mund të ketë një efekt shtypës në periudhën e oscilimit, i cili çon në një gabim në përcaktimin e densitetit [17].

fluska të vogla gazi të pranishme në të gjithë celulën e çuar të modelit të lëkundjeve dhe gjeneron një mesazh ka. Përveç kësaj, procesi i mbushjes së mostrës mund të

English Report | 14% Standard Similarity | Go to Standard Report

2% English Similarity | Filters

Sources | Show overlapping sources | Filters

Internet | core.ac.uk | <1%

1 text block | 164 matched words

1 of 3

https://core.ac.uk/doi/pdf/10.1088/0022-0220/19/1/011

from (5) 24 where KA and KB are apparatus constants, f_1 and f_2 are correction terms for temperature, viscosity and nonlinearity, and Q is a quotient of the periods of oscillation of two tubes [17]. The density and sound speed analyzer employ a reference oscillator that is also made of borosilicate glass, is filled with a known reference substance, and is subjected to the same conditions as the measurement oscillator. By dividing the period of oscillation of the measuring cell by the period of oscillation of the reference cell, certain thermal effects are compensated for. The correction for viscosity is required because sample viscosity can have a dampening effect on the period of oscillation.

Figura 19: Kontrolli i ngjashmërisë në modalitetin "Translated Matching".

Turnitin Assignment | Integrity | Turnitin

reports.eu.integrity.turnitin.com/#/submission-viewer/submission/turnid:2945296961594

Universiteti Politeknik i Tiranës - DKSHP
Disertacion Sk. I nga 3

Grade / 100

Similarity 2% | Flags | Feedback | Rubrics

Download

Similarity Report

Grading and Feedback Report

Original File

Internet | core.ac.uk | <1%

1 text block | 164 matched words

1 of 3

https://core.ac.uk/doi/pdf/10.1088/0022-0220/19/1/011

from (5) 24 where KA and KB are apparatus constants, f_1 and f_2 are correction terms for temperature, viscosity and nonlinearity, and Q is a quotient of the periods of oscillation of two tubes [17]. The density and sound speed analyzer employ a reference oscillator that is also made of borosilicate glass, is filled with a known reference substance, and is subjected to the same conditions as the measurement oscillator. By dividing the period of oscillation of the measuring cell by the period of oscillation of the reference cell, certain thermal effects are compensated for. The correction for viscosity is required because sample viscosity can have a dampening effect on the period of oscillation.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

FAKULTETI I

DEPARTAMENTI I

DISERTACION

Për mbrojtjen e Gradës Shkencore

"DOKTOR"

...tema e disertacionit...

Page 1 of 71 | 18419 words | 181%

Figura 20: Shkarkimi i raportit të originalitetit të skedarit të vlerësuar.






Figura 21: Raporti për skedarin e parë, për ngjashmërinë në gjuhën shqipe. 14% ngjashmëri.




Figura 22: Raporti për ngjashmërinë me modalitetin Translated Matching: 2% ngjashmëri.



UPT

Formulari 01.02.03 Data _____

RAPORT

mbi vlerësimin digjital anti-plagjaturë të disertacionit për fillimin e gradës shkencore "Doktor"

Fakulteti i _____
 Tema e disertacionit: _____
 Autor _____
 Udhëheqës Shkencor _____

Disertacioni, në formatin elektronik i përbërë nga _____ faqe, për qëllimin e vlerësimit digjital anti-plagjaturë, u nda në _____ skedarë.

Vlerësimi i ngjashmërisë lëshuar nga sistemi i detektimit anti-plagjaturë, për secilin skedar, tregon përqindjen e mëposhtme të ngjashmërisë.

Nr. skedari (I)	Nr. Faqe skedari	Numri i fjalëve të skedarit I (N_I) *	Ngjashmëria në gjuhën shqipe (P_I^A)	Ngjashmëria në gjuhën angleze (P_I^X)
1			%	%
2			%	%
3			%	%
4			%	%
5			%	%
Total #			%	%

Figura 23 Formulari 01.02.03, plotësohet nga vlerësuesi për gjetjet e origjinalitetit.



Shtojca 01.02.00-2

Udhëzues për ndarjen e disertacionit në disa skedarë

Parapërgatitja e disertacionit për vlerësimin anti-plagjaturë.

1. (Figura 24) Vlerësuesi kontrollon disertacionin në formatin PDF për numrin e karaktereve
 - a. Dokumenti hapet me Foxit PDF Reader
 - b. Lexohet numri i karaktereve në disertacion (numri i karaktereve është i përafërt kundrejt atyre të numëruar nga platforma turnitin, pasi softuer të ndryshëm, simbolet matematikore, fizike apo kimike, i numërojnë ndryshe mes tyre).
 - c. Kontrollohet nëse numri i i karaktereve është më i madh se 150,000.
 - d. Nëse kemi më shumë se 150,000 karakterei, materiali duhet të ndahet në skedar më të vegjël, të cilët nuk e tejkalojnë këtë numër (preferohet më pak se 140,000 për të marrë në konsideratë mënyrat e ndryshme që një softuer numëron simbolet).
 - e. Vlerësohet paraprakisht numri i faqeve ku do të ndahet disertacioni, që të përkojë me fund kapitulli apo skesioni, aty ku është e mundur në mënyrë logjike.
2. (Figura 25) Ndarja e materialit bëhet duke e hapur disertacionin origjinal në PDF me browser Google Chrome
 - a. Printohet në PDF material vetëm me faqet që do të përbëjnë skedarin më të vogël.
 - b. Për secilin skedar që printohet në PDF si pjesë të disertacionit, printohen edhe 3-4 faqet e para që përfshijnë kopertinën, titullin e punimit, emrin e doktorantit dhe udhëheqësit. Kjo realizohet duke vendosur numrin e faqeve përkatëse në printim si diapazon për pjesën e faqeve të para dhe gjithashtu edhe për faqet vijuese si në shembull: 1-4, 81-120.
 - c. Skedarët e printuar në PDF si nën pjesë të disertacionit emërtohen në mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht e kuptueshme rendi logjik i tyre në disertacionin origjinal.



